

Oerd BYLYKBASHI



Datëlindja: 23.05.1974

Vendlindja: Durrës

Email: Oerd.Bylykbashi@parlament.al

Jetëshkrimi:

Oerd Bylykbashi ka përfunduar studimet në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës (1992-1996) dhe më vonë në vitin (2011-2012) kreu studimet për Master në Shkencat Juridike Publike në të njëjtin Fakultet.

Nga viti 2007 deri në vitin 2009 Oerd Bylykbashi ishte Drejtor i Kontrollit të Brendshëm dhe Antikorrupsionit në Kryeministri.

Nga viti 2009 deri në vitin 2013 ishte përfaqësues i Partisë Demokratike në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve të Shqipërisë.

Në Legjislaturën e VIII (2013-2017) Oerd Bylykbashi u zgjodh deputet i Partisë Demokratike në Kuvendin e Shqipërisë. Ka qenë gjithashtu Nënkyetar i Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, bashkëkyetar i Komisionit të Posaçëm të Reformës Zgjedhore (2016-2017), nënkryetar i Komisionit të Posaçëm të Reformës në Drejtësi. Kryetar i Komisionit të Posaçëm për Dekriminalizimin (2015).

Ka qenë Deputet i Kuvendit të Shqipërisë Legjislatura IX 2017-2021 (dorëhequr në vitin 2019), nënkryetar i Grupit Parlamentar të PD-së si dhe bashkëkyetar i Komisionit të Posaçëm të Reformës Zgjedhore (2017-2019).

Oerd Bylykbashi ka qenë përfaqësues i Partisë Demokratike në Këshillin Politik për Reformën Zgjedhore (2020), ka qenë përfaqësues në negociatat politike në reformën zgjedhore (2001-2020), reformën në Drejtësi,(2015-2016), reformën për Dekriminalizimin (2014-2016).